



**MEMORANDUM MIRËKUPITIMI
MBI BASHKËPUNIMIN BILATERAL
NDËRMJET:**

**ZYRËS PËR HARMONIZIM E TREGUT TË BRENDSHËM
(MARKAT TREGËTARE DHE DISENJOT)
(E BASHKIMIT EUROPIAN)**

DHE

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PATENTAVE DHE MARKAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Zyra për Harmonizim e Tregut të Brendshëm (Markat dhe Disenjot) (OHIM) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM) e Republikës së Shqipërisë (këtu e më poshtë secila “Zyrë” dhe së bashku “Zyrat”).

Ku :

- 1) OHIM është Agjencia e Bashkimit Europian përgjegjëse për regjistrimin e markave dhe disenjove që janë të vlefshme në të gjitha 28 shtetet e Bashkimit Europian (BE), e zbatuar nga përdorues individual dhe kompani në BE dhe në mbarë botën për administrimin e përgjithshëm të këtyre të drejtave, duke qenë nën mbikëqyrjen e Bordit të tij Administrativ dhe Komitetit të tij të Buxhetit; dhe
- 2) Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM) është një autoritet qeveritar, në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. DPPM-ja është përgjegjëse për regjistrimin e aplikimeve për mbrojtjen e patentës, markave dhe disenjove. Roli kryesor i saj është të mbështesë industrinë Shqiptare dhe të promovojë rritjen ekonomike të vendit.

DUKE MARRË NË KONSIDERATË:

- 1) Faktin që Republikës së Shqipërisë i është dhënë statusi i vendit kandidat për anëtarësim në BE në Qershor 2014 dhe aktualisht është duke zhvilluar negociatat për aderim;

- 2) Gatishmërinë e Zyrave për të zhvilluar lidhje më të forta bashkëpunimi, që mund të çojnë në nxitjen e një partneriteti strategjik ndërmjet tyre;
- 3) Interesin e Zyrave për zgjerimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e eksperiencave në administrimin e pronësisë intelektuale, për qëllim të forcimit të sistemit dhe shërbimeve të tyre të pronësisë industriale; dhe
- 4) Faktin që Zyrat kanë burimet njerëzore, teknike dhe materiale për të zbatuar objektivat dhe angazhimet e përcaktuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

Paragrafi 1 Objekti

Ky Memorandum Mirëkuptimi përcakton termat dhe kushtet nën të cilat Zyrat do të krijojnë mekanizmat për bashkëpunim të përbashkët në fusha të cilat ato i konsiderojnë që janë prioritet.

Konkluzionet e këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk çenojnë krijimin e projekteve të përbashkëta nën programet ekzistuese apo ato në të ardhmen.

Paragrafi 2 Qëllimi i bashkëpunimit

1. Fokusi i aktiviteteve të bashkëpunimit në lidhje me markat dhe disenjot është në fushat e mëposhtme:
 - a. **Programet e trajnimit:** Zyrat do të bashkëpunojnë me njëra tjetrën mbi programet e trajnimit për pronën industriale, të hartuara për anëtarë të stafit apo për publikun e gjerë. Qëllimi i bashkëpunimit përfshin organizimin e seminareve dhe takimeve (*workshops*), ofrimin e kurseve të të mësuarit me internet dhe organizimin e vizitave për anëtarët e stafit. Do të lehtësohet bashkëpunimi ndërmjet DPPM-së dhe Akademisë OHIM.
 - b. **Takime ekspertësh për markat dhe disenjot:** Zyrat do të organizojnë takime vjetore të ekspertëve, për të diskutuar çështje madhore të lëna pezull, në fushën e markave dhe disenjove. Për këtë qëllim do të vlerësohet përdorimi i teknikave moderne të telekonferencave.
 - c. **Bashkëpunimi për çështjet në lidhje me statistikat e markave dhe disenjove:** Zyrat do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e të dhënave statistikore vjetore përkatëse dhe do të

diskutojnë çështjet përkatëse. Qëllimi i të dhënave statistikore, të cilat do të shkëmbehen, do të diskutohen në takimet e ekspertëve të përmendura më lart.

- d. **Shkëmbimi i të dhënave të markave dhe disenjove:** Zyrat do të bashkëpunojnë në çështjet që i përkasin shkëmbimit online të të dhënave të markave dhe disenjove industriale.

Zyrat do të diskutojnë mundësinë e ngarkimit të të dhënave të markave të regjistruara, të njëri tjetrit, në sistemet e tyre përkatëse të kërkimit të markave për publikun e gjërë. Në këtë kontekst, Zyrat pranojnë, që ato të dyja mbajnë bazë të dhënash (database) online për lehtësimin e aksesit të përdoruesve në të dhënat e markave të tyre. Ato pranojnë që bashkëpunimi në këtë fushë do të jetë përfitues për komunitetin e përdoruesve si në Republikën e Shqipërisë ashtu edhe në Bashkimin Europian. Për këtë qëllim, Zyrat njohin/pranojnë që integrimi i Republikës së Shqipërisë në TMView dhe DesignView, mjetet/mënyrat e konsultimit të zhvilluara nga OHIM në partneritet me Zyrat Europiane, është rruga që të çon përpara. Ato do të studiojnë bashkarisht fizibilitetin teknik të integritit të DPPM-së në TMView dhe DesignView dhe do të krijojnë një grup pune teknik për të analizuar kërkesat teknike dhe të biznesit të një integrimi të tillë.

- e. **Sistemet elektronike në lidhje me markat dhe disenjot:** Zyrat mund të kryejnë aktivitete bashkëpunuese në lidhje me zhvillimin dhe zgjerimin e IT-së së njëri tjetrit dhe skemat e modernizimit dhe automatizimit. Zyrat do të mbajnë takime me ekspertët e tyre të IT-së për të diskutuar çështjet madhore të IT-së dhe projektet. Për këtë qëllim do të vlerësohet përdorimi i teknikave moderne të telekonferencave.

- f. **Klasifikimi:** Zyrat pranojnë që përdoruesit do të përfitojnë nga bashkëpunimi i mëtejshëm midis Zyrave në mjetet/mënyrat e klasifikimit. Për këtë qëllim, Zyrat pranojnë që sigurimi i përdoruesve akses të lirë dhe të lehtë në bazën e të dhënave (database) të tyre përkatëse, do të ishte një hap i rëndësishëm përpara. Zyrat do të veprojnë së bashku mbi mundësinë e bashkëpunimit në të ardhmen brenda fushave të klasifikimit, duke përfshirë mundësinë e (DPPM-së) që të behët pjesë e TMclass.

- g. **Harmonizimi i praktikave të markave dhe disenjove:** Zyrat mund të bashkëpunojnë në aktivitete në lidhje me harmonizimin e praktikave të markave dhe disenjove. Aktivitete të tilla mund të realizohen, ndër të tjera, nëpërmjet pjesëmarrjes në Programet e Konvergencës aktuale dhe në ardhmen.

- h. **Aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit:** Zyrat mund të kryejnë aktivitete që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit të bizneseve, konsumatorëve dhe qytetarëve për vlerën e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (IPR) dhe Markat e Komunitetit (CTM) dhe disenjove të Regjistruara të komunitetit (RCD) në shoqërinë e sotme.

- i. **Mënyra të tjera të bashkëpunimit:** Kur është e nevojshme, për arritjen e objektivave të Memorandumit të Mirëkuptimit, Zyrat mund të përcaktojnë forma të tjera bashkëpunimi në të ardhmen dhe ti inkorporojnë ato në këtë Memorandum Mirëkuptimi si një shtesë specifike.
2. Zyrat do të bashkëpunojnë në fusha dhe forma të ndryshme në mënyrë që të racionalizojnë burimet, të krijojnë sinergji, të nxisin konvergjencën e praktikave dhe të promovojnë sëbashku përpjekje të përbashkëta për rezultate të përbashkëta.

Paragrafi 3 Zbatimi

Përpunimi i çdo projekti bashkëpunimi do të përfshijë detajet mbi shtrirjen, koordinimin dhe administrimin e projektit dhe çdo informacion tjetër përkatës. Zyrat do të hartojnë një plan vjetor zbatimi i cili specifikon të gjitha aktivitetet.

Paragrafi 4 Mbrojtja e Informacionit

1. Zyrat do të përdorin informacionin e siguruar gjatë vazhdimësisë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi ekskluzivisht për qëllime të brendshme, kërkohet miratim paraprak i Zyrës tjetër kur një Zyrë dëshiron të përdorë këtë informacion për qëllime të tjera.
2. Secila Zyrë garanton që dokumentat, informacionet dhe çdo njohuri tjetër të një natyre konfidenciale nuk do të përhapet apo transmetohet te palët e treta pa miratim paraprak të Zyrës tjetër.

Paragrafi 5 Financimi

1. Memorandum i Mirëkuptimit nuk përfshin transferimin e burimeve financiare ndërmjet Zyrave.
2. Programet, projektet dhe aktivitetet specifike do të financohen nga të dyja Zyrat sëbashku ose ekskluzivisht nga njëra prej tyre, në varësi të kufizimeve përkatëse buxhetore.

Paragrafi 6 Vazhdimi

1. Nevojitet ndjekja e vazhdueshme dhe vlerësimi për zbatimin, organizimin dhe funksionimin e veprimeve të ndërmarra sipas qëllimit të Memorandunit të Mirëkuptimit. Zyrat janë përgjegjëse për sa më poshtë:
 - a) Vlerësimin e rezultateve të veprimeve të zbatuara;
 - b) Identifikimin e fushave në të cilat bashkëpunimi duhet të forcohet dhe përmirësohet;
 - c) Përcaktimin e fushave të reja për veprime të përbashkëta dhe propozimin e projekteve, programeve dhe aktiviteteve të reja specifike;
 - d) Hartimin e rekomandimeve për përmirësimin e mekanizmave të bashkëpunimit
2. Ky vazhdim do të rishikohet gjatë një takimi vjetor të një niveli të lartë ndërmjet Zyrave.

Paragrafi 7

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyje në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi për pesë vjet. Ai mund të zgjerohet me miratimin e përbashkët me shkrim të Zyrave. Zyrat do të rishikojnë përmbajtjen e memorandunit rregullisht dhe do të bien dakort për një plan zbatimi në baza vjetore. Megjithatë ai mund të përfundohet nepërmjet marrëveshjes së përbashkët ose nga njëra Zyrë duke i dhënë gjashtë muaj njoftim paraprak tjetrës.

Paragrafi 8

Dispoziatat përfundimtare

1. Memorandumi i Mirëkuptimit mund të amendohet me miratim të përbashkët të Zyrave. Çdo modifikim duhet të formalizohet me shkrim dhe duhet të përfshijë datat kur modifikimet bëhen efektive.
2. Të gjitha çështjet apo mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Memorandunit të Mirëkuptimit duhet të zgjidhen me marrëveshje të përbashkët.
3. Me përjashtim nëse Zyrat bien dakort ndryshe, përfundimi i parakohshëm i Memorandunit të Mirëkuptimit nuk duhet të pengojë projektet apo aktivitetet në vazhdim.

Nënshkruar në katër kopje në Alicante dhe Tiranë, respektivisht dy në gjuhën Angleze dhe dy në gjuhën shqipe me tekst autentik ku kopja në gjuhën angleze ka përparësi.

Për Zyrën për Harmonizim të
Tregut të Brendshëm
(Markat Tregëtare dhe Disenjot)
(te Bashkimit European)




Z. António Campinos
President

18/3/2016

Data

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave
dhe Markave
të Republikës së Shqipërisë



Z. Elvin Lako
Drejtore i Përgjithshëm

27/03/16

Data



**MEMORANDUM OF UNDERSTANDING
ON BILATERAL COOPERATION
BETWEEN:**

**THE OFFICE FOR HARMONIZATION IN THE INTERNAL MARKET
(TRADE MARKS AND DESIGNS)
(OF THE EUROPEAN UNION)**

AND

**THE GENERAL DIRECTORATE OF PATENTS AND TRADEMARKS
OF THE REPUBLIC OF ALBANIA**

The Office for Harmonization in the Internal Market (Trade Marks and Designs) (OHIM) and the General Directorate of Patents and Trademarks (GDPT) of the Republic of Albania (hereinafter each "Office" and jointly "the Offices")

WHEREAS:

(1) The OHIM is the European Union Agency responsible for registering trade-marks and designs that are valid in all 28 countries of the European Union (EU), applied by individuals users and companies in the EU and worldwide and for the general administration of these rights, being supervised by its Administrative Board and its Budget Committee; and

(2) The General Directorate of Patents and Trademarks (GDPT) is a government authority organized under the Ministry of Economic Development, Tourism, Trade and Entrepreneurship. The GDPT is responsible for processing applications for patent protection, and for trade mark and design registration. Its primary role is to support Albanian industry and promote economic growth.

CONSIDERING:

(1) The fact that the Republic of Albania was granted the status of candidate country for EU membership in June 2014 and is currently undergoing accession negotiations;

(2) The willingness of the Offices to develop stronger cooperation ties that can lead to forge a strategic partnership between them;

(3) The interest of the Offices in expanding cooperation and sharing experiences in intellectual property administration, for the purpose of strengthening their intellectual property systems and services; and

(4) The fact that the Offices have the human, technical and material means to implement the objectives and commitments set out in this Memorandum of Understanding.

Have reached the following understanding:

Article 1 Object

The Memorandum of Understanding establishes the terms and conditions under which the Offices shall establish mechanisms for mutual cooperation in areas they consider to be a priority.

The conclusion of this Memorandum of Understanding does not prejudice the establishment of joint projects under the existing or future programmes.

Article 2 Cooperation scope

1. The focus of the cooperation activities related to trade marks and designs is on the following areas:

- a. **Training programs:** The Offices will cooperate with each other on intellectual property training programs designed for members of staff or the general public. The scope of cooperation includes the holding of seminars and workshops, the provision of e-learning courses, and the organization of study visits for staff members. Cooperation between the GDTP and OHIM's Academy will be facilitated.
- b. **Trade mark and design experts meeting:** The Offices will hold annual meetings of experts to discuss major pending issues in the field of trade mark and design. The use of modern teleconference techniques will be evaluated for this purpose.
- c. **Cooperation on matters related to the trade mark and design statistics:** The Offices will cooperate on the exchange annual relevant statistical data and discuss relevant issues. The scope of the statistical data to be exchanged will be discussed at the above-mentioned experts meeting.
- d. **Exchange of trade mark and design data:** The Offices will cooperate on matters pertaining to the online exchange of trade mark and industrial design data.

The Offices will discuss the possibility of uploading each other's registered trade mark data onto their respective trade mark search systems for the general public. In this context, the Offices acknowledge that they both hold online databases for facilitating the access of users to their trade mark records. They acknowledge that cooperating in this field will benefit the user community both in the Republic of Albania and in the European Union. For this purpose, the Offices recognize that the integration of the Republic of Albania into TMView and Designview, the consultation tools developed by OHIM in partnership with other European offices, is the way forward. They will jointly study the technical feasibility of GDTP's

integration into TMView and Designview, and they will establish a technical working group to analyze the technical and business requirements of such integration.

- e. **Electronic systems related to trade marks and designs:** The Offices may conduct cooperative activities related to the development and expansion of each other's IT, and automation and modernization schemes. The Offices will hold meetings of their IT experts to discuss major IT issues and projects. The use of modern teleconference techniques will be evaluated for this purpose.
- f. **Classification:** The Offices acknowledge that users would benefit from further cooperation between the Offices on classification tools. For this purpose, the Offices recognize that providing users with free and easy access to their respective classification databases would be an important step forward. The Offices will liaise on the possibility of future cooperation within the field of classification, including the possibility of (GDTP) joining TMclass.
- g. **Harmonization of trade mark and design practice:** The Offices may cooperate on activities concerning harmonization of trade mark and design practice. Such activities might be realized inter alia through participation in current and future Convergence Programmes.
- h. **Awareness raising activities:** The Offices may carry out activities aimed at raising the awareness of businesses, consumers and citizens on the value of Intellectual Property Rights (IPR) and Community Trade marks (CTM) and Registered community designs (RCD) in today's society.
- i. **Other means of cooperation:** Whenever appropriate for the achievement of the objectives of the Memorandum of Understanding, the Offices may establish other forms of cooperation in the future and incorporate them into this Memorandum of Understanding as a specific addendum.

2. The Offices will cooperate in the different areas and forms in order to rationalise resources, create synergies, foster convergence of practices and promote joint common efforts for common results.

Article 3 Implementation

The elaboration of any cooperative project should include details on the extent, coordination and administration of the project and any other relevant information. The Offices shall draw up an annual implementation plan that specifies all the activities.

Article 4 Protection of information

1. The Offices shall use the information obtained during the course of the present Memorandum of Understanding exclusively for internal purposes, the prior consent of the other Office being required when one Office wishes to use such information for other purposes.

2. Each Office guarantees that the documents, information and any other knowledge of a confidential nature will not be disclosed or transmitted to third parties without the prior consent of the other Office.

Article 5 Financing

1. The Memorandum of Understanding does not involve the transfer of financial resources between the Offices.
2. The programs, projects and specific activities shall be financed by both Offices jointly or by any one of them exclusively, depending on the respective budgetary limits.

Article 6 Follow-up

1. Ongoing follow-up and assessment is required for the implementation, organisation and functioning of the actions undertaken within the scope of the Memorandum of Understanding. The Offices are responsible for the following:
 - a) Assessing the results of the implemented actions;
 - b) Identifying the areas in which cooperation should be strengthened and improved;
 - c) Determining new areas for joint actions and proposing new projects, programs and specific activities;
 - d) Drafting recommendations for improving cooperation mechanisms.
2. This follow-up shall be reviewed during a high level annual meeting between the Offices.

Article 7 Entry into force and termination

The Memorandum of Understanding will come into effect on the date of the signature and remain in effect for five years. It may be extended with the mutual written consent of the Offices. The Offices will revise the content of the memorandum on a regularly basis and agree an implementation plan on an annual basis. It may however be terminated through mutual agreement or by one Office giving the other six months of prior notice.

Article 8 Final provisions

1. The Memorandum of Understanding may be amended with the mutual consent of the Offices. Any modifications must be formalized in writing and should include the dates when the modifications become effective.
2. All matters or disputes related to the interpretation and application of the Memorandum of Understanding should be resolved by mutual agreement.
3. Unless the Offices agree otherwise, early termination of the Memorandum of Understanding should not hinder any ongoing projects or activities.

IN WITNESS WHEREOF, four original copies have been signed in Alicante and Tirana respectively, two in English and two in Albanian language, the texts being equally authentic. In case of any difference in interpretation, the English text shall prevail.

For the Office for Harmonization
in the Internal Market
(Trade marks and Designs)
(of the European Union)




Mr António Campinos
President

18 / 3 / 2016

Date

For the General Directorate of Patents
and Trademarks of the Republic of
Albania



Mr Elvin Lako
Director General

27/02/16

Date

